"KUSH DO TA PASOJË UDHËZIMIN TIM, AS NUK DO TË HUMBË, AS NUK DO TË BJERË NË MJERIM!"

PËR PROZATORIN E TALENTUAR SUAD ARILLA E MË GJERË

"MUHAMEDI I VOGËL"
(TREGIM I VËRTETË NGA HISTORIA E INKUIZICIONIT NË ANDALUZI)

UDHA ISLAME

Botim i Myftinisë Shkodër
E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative

Viti 22 - Nr. 1 (251), Janar, 2024

www.myftinia-shkoder.org

MYFTINIASHKODER1990



"Gjatë periudhës së sundimit islam, nga Andaluzia në Indi, nuk kishte vend të përparuar e vend të prapambetur!
Civilizimi dhe qytetërimi islam i përfshiu të gjithë!"

Al-Hambra - Andaluzi, Spanjë

ZHVILLOHET KONFERENCA E 12-TË VJETORE E IMAMËVE: "NJERIU, BARTËS I AMANETIT!"

IMAM DIDMAR FAJA: "TË MENDOJMË MIRË PËR ZOTIN TONË DHE TA BËJMË TË DASHUR PËR TË TJERËT!"

BULETINI I PËRVITSHËM I MYFTINISË SHKODËR, VAZHDON RRUGËTIMIN E TIJ...

PESHORJA E GJYKATËS NDËRKOMBËTARE!

U ZHVILLUA TRIBUNA FETARE: "TRE MUAJ BEKIM DHE AFRIM!"

DITËT DHE NETËT E SHËNUARA ISLAME (2024 | 1445-1446 H)

“KUSH DO TA PASOJË UDHËZIMIN TIM, AS NUK DO TË HUMBË, AS NUK DO TË BJERË NË MJERIM!”

Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

“Ç’do njeri ká nevojë për këshillat e mâ të dijshmit,

për arsye se njerëzit qi përbâjnë shoqnín njerzore

nuk janë në të njajten shkallë në pikpamje dijtunore”[1]

Në referatin tim, do të trajtoj përmbajtjen dhe mesazhet e ajetit 123 të sures TaHa, ku Krijuesi i gjithësisë na sjell në vëmendje një moment shumë vendimtar për jetën dhe të ardhmen e racës njerëzore; zbritjen e dy prindërve tanë të mëdhenj nga xheneti në tokë dhe hartën e zhvillimit të jetës, nga ai moment.

“Kur t’ju vijë udhëzim nga ana Ime, kush do ta pasojë udhëzimin Tim, as nuk do të humbë, as nuk do të bjerë në mjerim!” Ky është vendimi hyjnor, pas të cilit nis edhe jeta mbi faqen e dheut dhe lëvizja e njerëzve të parë, deri në këtë ditë e deri në kiamet!

Jeta e njeriut në tokë është e mbushur me sprova, lodhje, përpjekje të vazhdueshme, sakrifica, të papritura e befasi, që shpesh ia prishin ekuilibrin e jetës, por “edhe pse njëriu në këtë jetë është i sprovuar, ai, në këtë botë është posedues i vullnetit të lirë! Allahu i Madhëruar ka vendosur kudo argumente; çdo gjë përreth nesh e falënderon Atë, çdo gjë na tërheq drejt Tij. Kjo do të thotë se nëse ti e ndjek udhëzimin e Tij në çdo gjë, nuk do të humbësh, as do të biesh në mjerim: as mendja jotë, as shpirti yt; përkundrazi, do të lumturohesh, do të lartësohesh, do të korrësh sukses, do të triumfosh, do të fitosh dhe do të realizosh qëllimin tënd si krijesë mbi faqen e dheut!”[2]

Në shpjegimin e ajetit të lartpërmendur, Imam Kurtubiu na sjell në vëmendje fjalët e Ibn Abbasit (r.a), që thoshte se: “Allahu ia ka garantuar atij që e lexon Kur’anin dhe vepron me përmbajtjen e tij, se nuk do të devijojë në këtë botë dhe nuk do të mjerohet në ahiret, - dhe lexoi ajetin”[3] Poashtu thoshte: “Ai që e lexon Kur’anin dhe e pason atë që përmban, Allahu do ta udhëzojë larg devijimit dhe do ta mbrojë në jetën e përtejme nga e keqja e llogarisë, - pastaj lexoi ajetin ”.[4]

Imam Alusi, në tefsirin e këtij ajeti, shkruan se: “Disa e kanë komentuar udhëzimin me Kur’anin, duke u nisur nga ajo që transmeton Ibn Ebi Shejbe, Abdurrahman ibn Hamid, Ibn Ebi Hatim, El-Hakim që e ka saktësuar dhe Bejhekiu në Shuabul-Iman nga disa rrugë, nga Ibn Abbasi (r.a) që ka thënë: ‘E ka ruajtur Allahu pasuesin e Kur’anit, nga devijimi në këtë botë, a mjerimi në ahiret’, - pastaj lexoi ajetin”.[5]

Në tefsirin e këtij ajeti lexojmë edhe shpjegimin me vlerë të Molla Ali Hereviut, që shpjegon se: “Kur t’ju vijë udhëzim nga ana Ime”; Libër dhe i dërguar. “Kush do ta pasojë udhëzimin Tim as nuk do të humbë”; në këtë botë. “as nuk do të bjerë në mjerim!”; as do të lodhet në të përtejmen.[6] Po aty, mësojmë se: “Kush do ta pasojë udhëzimin Tim”; dmth, udhëzimin drejt kapjes për Librin dhe Traditën e të dërguarit, as do të devijojë nga rruga e udhëzimit, as do të mjerohet në të përtejmen , as në këtë botë!”[7]

“Njeriu që nuk e njeh të vërtetën, është njeri i metë, me mangësi dhe defektoz.., ai është përherë në ankth dhe frikë... Sa e sa njerëz jetojnë jetën e tyre në një drejtim të caktuar, pastaj, një moment të caktuar zbulojnë se rrugëtimi i tyre ka qenë i gabuar!? Sa e sa njerëz kanë menduar se ajo që po bëjnë është çdo gjë, por në fund të jetës kanë kuptuar se ajo ka qenë diçka e pavlerë, për të cilën kanë humbur jetën?! Zhgënjimi në vjeshtën e moshës, është një peshë e papërballueshme..!”[8]

Njerëzit në këtë botë janë dy llojesh: lloji i parë bën pjesë në këtë ajet të rëndësishëm për jetën e secilit, ndërsa lloji i dytë, tek ajeti vijues: “Kushdo që i kthen shpinën Këshillës Sime, do të ketë jetë të mjeruar dhe Ne, në Ditën e Kiametit, do ta ringjallim të verbër!”[9] Pra, kush jeton i verbër përballë thirrjes së Krijuesit të Tij, argumenteve dhe dritës që Ai na shpërndan ditë pas dite, duke na ftuar drejt Dashnisë së Tij, në ditën e gjykimit do të ringjallet i verbër, në përligjje me verbërinë e përzgjedhur në jetën e kësaj bote kalimtare!

“Meqë shkak i daljes së Ademit dhe Havasë u bë devijimi i tyre nga udhëzimet dhe, kjo natyrë e devijuar u bë shkak i daljes nga rruga e drejtë, Allahu i Madhëruar na përmend nevojën e dërgesës së të dërguarve dhe se Ai, Madhëruar qoftë, do të jetë dërguesi i tyre. Kështu, kushdo që do t’i pasojë ata, do të jetë i lumtur dhe mospasuesi, i mjerë dhe i dëbuar!..

Sepse në zbatimin e ligjeve të Allahut dhe në të kapurit e saktë pas udhëzimit të Tij, ka përmirësim për nefsin, organizim për gjendjet (nëpër të cilat kalon njeriu), ndalim në kufijtë e përcaktuar, dorëzim para të drejtave, ndjekje e rrugës së drejtë, që përputhet me rregullin universal dhe natyrshmërinë njerëzore! Këtu mblidhet krejt e mira dhe rregulli për racën njerëzore në çështjet e tyre sociale dhe drejtimin e tyre në qetësi dhe prehje, [por edhe në ato shpirtërore dhe çfarë pasohen me shpërblimet dhe bekimet në jetën e përtejme!”[10]

NJERIU I SOTËM, E KA HUMBUR RRUGËN!

“Nuk ká dyshim se për m’u zhvilluem në mëndie, për m’u pajuem me dijtuní e për m’u gdhënë mâ së fundmi në shpirtë, duhet domosdo qi të ndihmohemi prej mâ të dijshëmvet. Ç’do sëmundje në kët botë ka nevojë për m’u mjekuem. Kështû dhe mjekët e smundjevet morale e shoqnore janë ylemât, qi përpiqen me përmirsuem moralin e popullit dhe m’e ngritë këtê shpirtnisht në nji shkallë t’epër.

...

Detyra e predikuesvet duhet të jetë: Me ndritsue mëndjen e popullit, me ia mësuem popullit parimet e sakta të fesë e me i dhanë nji edukatë qytetnore e shoqnore jo të bastardhueme. Duhet me dijtë se shekulli i sotshëm e sidomos perjudha pas luftës botnore, i kanë dhanë shkak perhapjes të shum smundjevet morale në botë dhe kanë pertrimë ndryshime fort paradoksale në mentalitetin botnuer. Kshtû sot per predikuesin bâhet mâ e vështirë detyra se tjera herë. Prandaj vendi i predikuesit nuk duhet t’i lihet i lirë do kujdo; por atij qi zotnon të gjitha cilësínat e merituesshme të nji predikuesi.”[11]

Në suren “En-Nahl”, lexojmë se: “Cilindo mashkull apo femër që kryen vepra të mira, duke qenë besimtar, Ne do ta bëjmë që të kalojë jetë të bukur dhe do ta shpërblejmë sipas veprave më të mira, që ka bërë.”[12]

Betohet Vetë Zoti ynë se besimi dhe vepra e mirë, sipas përkufizimit hyjnor, janë garanci e një jete të bukur, larg dëshpërimit, kaosit, ngarkesave dhe devijimit!

Teksa punoja për monografinë kushtuar jetës dhe veprës së Hoxhës tonë të madh shqiptar, dijetarit dhe eruditit të pashembullt, H. Vehbi S. Gavoçi (rahmet pastë), ndër të tjera e pyeta se cilat janë disa prej pengesave të Thirrjes Islame në këtë kohë dhe si mund të kapërcehen?

Hoxha m’u përgjigj: “Vesveset e të mallkuarit që të zbukurojnë rrugën e shtrembër, duke e ushqyer atë me gra e pije, me pasuri të dyshimtë e dëfrime pa kufij.

Të largojnë nga mendja pyetje të tilla, si: Kush jam unë? Kush më ka krijuar dhe përse? Çfarë duhet të veproj në këtë jetë të gjatë, ku për çdo ditë duhet të lodhem për veten e familje? Ku do të shkoj nesër, kur të vdes e të lë këtë jetë?

Nëpërmjet kërkesave të ulëta e nëpërmjet epsheve të lira, të mbyll syrin për të parë të vërtetën, të shurdhon për të dëgjuar zërin e arsyes dhe logjikës, të ndalon të përdorësh mendjen si duhet, etj.

Të gënjen me pije, të lakmon femrën e të bën të mendosh se nuk ka ringjallje pas kësaj jete, kështu që duhet shfrytëzuar çdo moment për të ushqyer epshet!”

Në hadith, mësojmë se: “Cilido popull, në mesin e të cilit veprohen veprat e ndaluara, të cilat kanë mundësi t’i ndryshojnë dhe nuk i ndryshojnë, do t’i përfshijë Allahu me ndëshkim!”[13]

Realitetet me të cilat përballet sot bota e jonë në përgjithësi dhe, shoqëria e jonë islame në veçanti, i përngjajnë një labirinthi të errët, ku njeriu hyn dhe ngelet peng i hutimit, i humbjes së kohës, i dështimit dhe i moskonkurimit për të arritur më të mirën në jetë, duke e jetuar atë sipas udhërrëfimit hyjnor, me të cilin Zoti e ka begatuar jetën tonë.

Shoqëria e jonë sot, përballet me tendencat e asimilimit, tjetërsimit, ndryshimit të identitetit, ndryshimit të kulturës dhe çrrënjosjes së vlerave (islame), me të cilat të parët tanë jetuan në paqe, harmoni dhe begati, me natyrën, me njeriun (cilindo njeri), me veten (d uke dëshmuar paqen e brendshme me Zotin) dhe gjithçka përreth.

Dekadat e fundit, po bëhen përherë e më shumë më të egra me muslimanin shqiptar, atë evropian dhe në mbarë botën, duke i ofruar atij modele dhe shembuj, që nuk janë as mund të jenë bashkudhëtarë me botën e tij, me shpirtin e besimit dhe vlerat e Islamit.

Ditë pas dite shoqëria e jonë islame, po përballet me një propagandë sa të fshehur aq të dukshme, në thelbin e së cilës është frika nga Islami dhe tendenca për ta paraqitur atë si një fenomen keqbërës e të kobshëm, që për shekuj e paska ngërthyer për fyti shqiptarin, duke ia marrë frymën atij, duke ia zbehur forcën dhe dritën e shpirtit. Por, kjo nuk është e vërtetë! Është qesharake!

Ditë pas dite, po dëgjojmë thirrje patetike dhe analiza plot patos, në të cilat flitet rreth dëmeve që Islami (besimi) i ka sjellë popullit tonë, kombit tonë, si dhe rrezikut të madh që i kanoset kontinentit tonë nga vërshimi i tij drejt zemrës së Evropës së lashtë!? Janë thjeshtë thirrje të vjetra në petkun e ri të kohës, por që në thelb fshehin tërheqjen e individit dhe shoqërisë drejt dëshpërimit dhe kaosit të jetës pa besim dhe norma, sikurse lexojmë dhe dëgjojmë ditë pas dite!?

Nuk janë larg vëmendjes tuaj thirrjet për djegien e Kur’anit, karikaturat bastardhe, ndalimi i hixhabit dhe persekutimi i vajzave dhe grave muslimane, që u përhap si një zgjebë në xhahilijetin e disa institucioneve tona në trojet shqiptare, diskursi politik i të djathtës ekstreme në Evropë kundër të drejtave të muslimanëve, kufizimeve, thirrjet për dëbimin e refugjatëve e të ngjashme.

Nga ana tjetër, shohim përherë e më shumë meshkuj që kthehen në femra, fëmijë që nuk pyesin për prindër, shtimin e numrit të divorceve për teka banale, vartësi ndaj bimëve narkotike, krimet e shtuara, grabitjet dhe mungesa e sigurisë, martesa brenda të njëjtës gjini, shitja e organeve njerëzore, konsumimi i friksh ë i drograve të ndryshme, alkoolizimi i shoqërive, trafikimi i qenieve njerëzore, kanabisizimi i rinisë, por jo vetëm, janë alarme të përhapjes në masë të dëshpërimit, anarshisë dhe prishjes së ekuilibrit të besimit dhe mungesës së tij në jetën e njeriut të kësaj kohe!

4

> “Allahu i Madhëruar ka vendosur kudo argumente; çdo gjë përreth nesh e falënderon Atë, çdo gjë na tërheq drejt Tij. Kjo do të thotë se nëse ti e ndjek udhëzimin e Tij në çdo gjë, nuk do të humbësh, as do të biesh në mjerim: as mendja jotë, as shpirti yt; përkundrazi, do të lumturohesh, do të lartësohesh, do të korrësh sukses, do të triumfosh, do të fitosh dhe do të realizosh qëllimin tënd si krijesë mbi faqen e dheut!

1. *H. I. Dibra, Predku e Predikuesat (vazi e vaizët), në revistën Zâni i Naltë, vjeti VI, Shevvall 1348 – Marc 1930, nr. 4, f. 951.*
2. *Dr. Muhammed Ratib En-Nabulsi, Tefsirun-Nabulsi, botimi i parë, Muessesetul-Fursan, Amman 2016, vëll. i 5-të, f. 448.*
3. *Imam Ebu Abdullah Muhammed ibn Ahmed El-Ensari El-Kurtubi, El-Xhamiu liahkamil-Kuran, botimi i dytë, Darul-Hadith, Kajro 1996, vëll. i 11- të, f. 275.*
4. *Po aty, vëll. i 11-të, f. 275.*
5. *Imam Ebul-Fadl Shihabuddin Es-Sejid Mahmud El-Alusi El-Bagdadi, Rruhul-meani, botimi i katërt, Darul-kutubil-ilmijjeh, Bejrut 2014, vëll. i 8-të, f. 584.*
6. *Imam Nurudin Ali bin Sulltan El-Herevi, Envarul-Kuran ve esrarul-Furkan, botimi i parë, Darul-kutubil-ilmijjeh, Bejrut 2013, vëll. i 3-të, f. 306.*
7. *Po aty, vëll. i 3-të, f. 306.*
8. *Po aty, f. 448.*
9. *Kur’ani, TaHa: 124.*
10. *Shejkh Reshid El-Khatib El-Meusili, Tefsirul-Kur’anil-Adhim, botimi i parë, Ervika lid-dirasat vennesh, Amman 2014, vëll. i 5-të, f. 142-143.*
11. *H. I. Dibra, Predku e Predikuesat (vazi e vaizët), në revistën Zâni i Naltë, vjeti VI, Shevvall 1348 – Marc 1930, nr. 4, f. 953-954.*
12. *Kur’ani, En-Nahl: 97.*
13. *Transmetuar nga Ebu Davudi, nga Ebu Bekri (r.a).*

Po lexoja në revistën Zâni i Naltë, 1933, një artikull me titull: “Alkoolizma”, në krye të cilit shënohet: “Shkenca s’ka fuqi me e pengue këtë ves të rrezikshëm për racën njerzore; por Feja ja thán rrâjen”[14]

“Shqipëria është një nga vendet kryesore tranzit të trafikimit të heroinës dhe kokainës të identifikuara nga UNODC (Zyra e Kombeve të Bashkuara kundër Drogës dhe Krimit) në raportin e fundit të drogave.

Sipas raportit, përdorimi i drogës vazhdon të jetë i lartë në mbarë botën. Në vitin 2021, 1 në çdo 17 persona të moshës 15-64 vjeç në botë kishte përdorur një drogë në 12 muajt e fundit. Numri i vlerësuar i përdoruesve u rrit nga 240 milion në 2011 në 296 milion në 2021 (5.8 për qind e popullsisë globale të moshës 15-64 vjeç). Kjo është një rritje prej 23 për qind, pjesërisht për shkak të shtimit të popullsisë.

Kanabisi vazhdon të jetë droga më e përdorur, me rreth 219 milionë përdorues (4.3 për qind e popullsisë së rritur globale) në vitin 2021. Përdorimi i drogës po rritet dhe megjithëse globalisht përdoruesit e kanabisit janë kryesisht meshkuj (rreth 70 për qind), ndarja gjinore po zvogëlohet në disa nënrajone; gratë përbëjnë 42 për qind të përdoruesve të kanabisit në Amerikën e Veriut.

Vlerësohet se në vitin 2021, 36 milionë njerëz kishin përdorur amfetaminë, 22 milionë kishin përdorur kokainë dhe 20 milionë kishin përdorur substanca të llojit “ekstazi” vitin e kaluar.

Përqindja e përdoruesve femra është më e lartë në rastin e stimuluesve të llojit amfetamine (45 për qind e përdoruesve janë gra) dhe përdorimi jomjekësor i produkteve farmaceutike (midis 45 dhe 49 për qind e përdoruesve janë gra), ndërsa pjesa më e lartë e meshkujve gjendet tek përdoruesit e opiateve (75 për qind) dhe kokainës (73 për qind), sipas raportit.”[15]

Në vitin 1993, kur sapo kisha mbërritur në Damask, si student, doli në qarkullim një botim serioz i Shtëpisë botuese “Darul-Kalem”, me titull: “Mjekë perëndimorë që japin alarmin për pirjen e alkoolit”, me autor Dr. Hassan Shemsi Basha.

Libri, ndër të tjera bën fjalë edhe për përhapjen e frikshme të alkoolit në Amerikë, deri në atë gradë sa konsiderohet si: “vrasësi i dytë”. Autori, duke iu referuar librit të famshëm: Harrison’s Principles of internal Medicine – (Mc Grraw Hill, New York, 1992), na sjell në vëmendje se: “90% e njerëzve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës e konsumojnë alkoolin. 40-50% e burrave atje, goditen nga probleme kalimtare për shkak të pijeve dehëse, ndërsa 10% e burrave dhe 3-5% e grave janë të prekur nga vartësia ndaj alkoolit”[16]

Poashtu, ai tregon me fakte të shumta për dëmet e alkoolit në Evropë, ku lexojmë se: “Franca konsiderohet si vendi evropian me më shumë ankesa nga ky problem. Ndërsa në Britaninë e Madhe, sipas British Journal of Addiction 1987, 82:27, ‘Humbjet e shkaktuara nga problemet e alkoolit në shëndetësi, arrijnë shumën prej 640 milion paund në vit. Ndërsa humbjet e përgjithshme për shkak të konsumimit të pijeve dehëse arrijnë shumën e dy mijë milion paund në një vit!’

Artikulli në fjalë kujton gjithashtu se: ‘Dyqind mijë persona vdesin për çdo vit në Angli, për shkak të alkoolit’...

Në librin: Safe food, 1991, lexojmë: ‘Gjysmën e krimeve që ndodhin në Britaninë e Madhe, e kryejnë njerëz të dehur. Një e treta e aksidenteve rrugore ndodhin për shkak të alkoolit. Alkooli është shkaktar i: 2/3-tave të vetëvrasjeve në Angli, i 1/5-tës së ngacmimeve seksuale të fëmijëve, i gjysmës së vdekjeve për shkak të zjarreve, i 3/5-tave të lëndimeve të rrezikshme në kokë, i 1/3-tës së lëndimeve brenda shtëpisë’...”[17]

Poashtu lexojmë në enciklopedinë e Universitetit të Kalifornisë në ShBA, (botimi i vitit 1991): “Një e treta e të rinjve në Amerikë konsumon pije dehëse deri në gradën e pamundësisë së aktivitetit studimor në shkolla, ose që shpie në probleme me ligjin amerikan. Shumica e këtyre të rinjve e kanë nisur konsumimin e pijeve dehëse para moshës 13 vjeçare!”[18]

Po të vazhdojmë më tutje, në rrezikun e madh të sëmundjeve të frikshme, për shkak të marrëdhënieve intime jashtëmartesore, do të gjejmë shifra dhe të dhëna, gati-gati të pabesueshme, por të vërteta. Fjala bie: “Prania e virusit (HIV) tek njeriu, përbën një sfidë të madhe për punonjësit në sektorin e shëndetësisë dhe mjekësisë njerëzore në mbarë botën.

Në fillim të muajit gusht 1988, janë regjistruar 100.410 raste prekjesh me SIDA, sipas të dhënave të OBSH-së. Këto prekje ishin evidente në 138 shtete të botës. Momentalisht, ka 5-10 milion njerëz të prekur nga ky virus...”[19]

> “
>
> **Në revistën Zâni i Naltë, 1933, një artikull me titull: “Alkoolizma”, në krye të cilit shënohet: “Shkenca s’ka fuqi me e pengue këtë ves të rrezikshëm për racën njerzore; por Feja ja thán rrâjen!”**

Mendimtari dhe dijetari i madh me famë botërore, Shejkh Muhammed El-Gazali, në kryeveprën e tij: “E vërteta e hidhur”, flet për dëmet e kryqëzatave të perëndimit në Afrikë, shkruan: “... çfarë fitoi kontinenti i errët, siç e quanin?! 10 milion prekje nga AIDS! Sepse marrëdhëniet intime në Evropë bënë që 60% e fëmijëve të linden me baballarë jolegjitimë, pa asnjë siklet. Çfarë pret t’i ofrojnë këta njerëzve?!”[20]

Duke u kthyer në tefsirin e ajetit 97 të sures “En-Nahl”, Dr. Muhammed Ratib En-Nabulsi në veprën e tij, shkruan: “vepra e mirë: është të vepruarit konform asaj që ka ardhur në Kur’anin Famëlartë dhe në Traditën e Pastër... Lumturia që fiton besimtari, kur drejtohet në rrugën

14. *Pa emër autori, Alkoolizma, në revistën Zâni i Naltë, viti IX, Shtatuer 1933 – Xhemazi-Evvel Xhemazi Ahar, nr.1, 20.*

15. *https://www.monitor.al/raporti-i-drogave-i-okb-se-per-2023-shqiperia-nder-vendet-kryesore-ne-tranzitimin-e-heroines-e-kokaines/*

16. *Dr. Hassan Shemsi Basha, vep. e cit., f. 9.*

17. *Po aty, vep. e cit., f. 12-13.*

18. *Po aty, f. 17.*

19. *M.A. Ansary – S.K. Hira – A.C. Bayley – C. Chintu – S.L. Nyaywa, AIDS, Sh.b. Er-Reshid, botimi i parë, Damask, 1993, f. 3.*

20. *Muhammed El-Gazali, El-Hakkul-murr, Darul-Kalem, Damask 2022, botimi i parë, vëll. i 5-të, f. 258-259.*

e urdhëresave të Allahut, kur ndjen se Allahu është i kënaqur me të dhe se Ai do t’ia shtojë atij dashurinë, do ta mbrojë... ju betohem, kjo është jeta e mirë, me të cilën gëzohet çdo frymë, sikurse ndjenja e njeriut se Allahu i Madhëruar është i kënaqur me të, kjo është jeta e mirë dhe e bukur!”[21]

Pra, raca njerëzore ka nevojë për atë që thotë dijetari i shquar, H. Reshid El-Khatib El-Meusili (1303-1400 h.), në tefsirin e tij: “këto mësime janë rregull për racën njerëzore, prandaj kushdo që punon me to: ‘mashkull apo femër që kryen vepra të mira, duke qenë besimtar’, sepse besimi (imani), është burimi i veprave të mira në formën e tyre të saktë: ‘Ne do ta bëjmë që të kalojë jetë të bukur’...”[22]

Nga ana tjetër, karshi kësaj fushate të vjetër që thërret në prishje e dëshpërim, secilit prej nesh, i del për detyrë, që të kontrollojë veten e tij, ta marrë për dore drejt udhëzimit dhe më pas të kalojë tek tjetri, me kështillë dhe urtësi, në rrugën e rregullimit të asaj që është prishur dhe që ka për tendencë të degradojë në tjetërsim.

Këtë ndërmarrje besimi dhe udhëzimi, secili ta bëjë siç thotë Imam Gazaliu: [Transmetohet se All-llahu i Madhëruar i shpalli Hz. Isait (a.s): “O Isa, kështilloje nefsin tënd, nëse ai e pranon kështillën, kështillo edhe njerëzit, përndryshe, të kesh turp prej Meje!”][23]

Përhapja në masë në realitetet shqiptare e alkoolit, trashëgimi i veseve më negative nga periudha e ateizmit, si: gënjeshtra, mashtrimi, prerja në besë, smira, përgojimi në masë, egoizimi i sëmurë, sharja me shenjtëritë e fesë (për fat të keq akoma vazhdojmë të dëgjojmë aty-këtu), betimi në krijesat e Zotit, jo në Madhninë e Tij, kopracia, imoraliteti, zhveshja e femrës në emër të modave dhe etiketave të kohës, mosfalja e namazit, mosagjërimi, moslexim i Kur’anit, mosmësimi i dijeve elementare të fesë, mosthellimi në dije e shkencë, privimi nga dhënia e zekatit, mosbërja e dhikrit në formë të përditshme (në shtëpi, xhami, punë etj.), zbrazja e shtëpive nga salavati, tehexhudi, namazi i natës e lutjet në sexhde, ndalimi i fëmijëve për të ndjekur mësimet e besimit a shfaqjes së etiketës islame dhe moralit të përkushtimit, kamata, rushfetet etj, janë një alarm i madh për besimtarët, për krejt shoqërinë tonë!

Ato janë një ftesë për të kthyer vëmendjen drejt një urdhërese të hershme islame, të zbritur në Kur’an, të porositur nga Resulullahu (a.s), të zbatuar nga sahabët dhe brezat pas tyre, shekull pas shekulli: Urdhërimi për të mirë dhe ndalimi i të keqes në jetë!

Në Kur’anin Famëlartë, Zoti urdhëron: “(O Muhamed) Merre të lehtën, urdhëro për mirë dhe largohu prej të padijshmëve.”[24] Poashtu urdhëron: “Nga ju le të jetë një grup që thërret në atë që është e dobishme, që urdhëron për punë të mbara dhe ndalon nga e keqja. Të tillët janë ata të shpëtuarit.”[25]

Në komentimin e këtij ajeti, Imam Razi në tefsirin e tij, tërheq vëmendjen, se: “Pjesa: “Nga ju le të jetë një grup”, nuk ka për qëllim veçimin e një grupi të caktuar, për dy arsye: E para: sepse Allahu ia ka obliguar krejt ymetit urdhërimin për mirë dhe ndalimin e të keqes, në ajetin 110 të sures Ali Imran, ku thotë: “Ju jeni populli më i dobishëm, i ardhur për të mirën e njerëzve, urdhëroni për mirë, ndaloni nga veprat e këqija dhe besoni në Allahun”. Së dyti: Çdo i ngarkuar me obligueshmëritë e adhurimeve (mukelef), e ka për detyrë të urdhërojë për të mirë dhe të ndalojë nga e keqja, me dorën e tij, me gjuhën e tij ose me zemrën e tij, sikurse secili e ka për detyrë të largojë të keqen nga vetja. Nëse është kështu, themi se: kuptimi i këtij ajeti është: Bëhuni thirrës drejt të mirës, duke urdhëruar për të mirë dhe duke ndaluar të keqen...”[26]

Allahu i Madhëruar i ka cilësuar besimtarët, si njerëz që janë pranë njëri-tjetrit, të dashur në mes vete, të lidhur me mirësitë e besimit, në mbrojtje të kësaj shoqërie të lartë besimi, sipas kuptimeve të ajetit 71 të sures Teube, ku thotë: “Besimtarët dhe besimtaret janë të dashur për njëri-tjetrin, urdhërojnë për të mirë, ndalojnë nga e keqja, e falin namazin dhe japin zekatin, respektojnë Allahun dhe të dërguarin e Tij. Të tillët do t’i mëshirojë Allahu.”[27]

Ndërsa Resulullahu (a.s), thoshte: “Çdo profeti, që Allahu ka dërguar në ymetin përkatës, para meje, i ka dhënë nga ai popull përkrahës dhe shokë, që ndiqnin traditën e tij dhe e zbatonin fjalën e tij. Pastaj, nga ata erdhën breza, që thonin atë që nuk e vepronin dhe që vepronin atë për të cilën nuk urdhëroheshin. Kushdo që i ndalon ata me dorën e tij, është besimtar! Kushdo që i ndalon ata me gjuhën e tij, është besimtar! Kushdo që i ndalon ata me zemrën e tij, është besimtar! E pas kësaj, nuk mbetet më as sa një kokërr meli, besim!”[28]

Dhe, sikurse kanë thënë edhe dijetarët tanë: “kur muslimanët e lanë pas dore këtë obligim dhe e neglizhuan zbatimin dhe përkujdesjen ndaj tij, u kushtoi përçmim e nënshtrim, humbje dhe devijim. U zvogëluan në sytë e të huajve dhe u sulmuan në shtëpitë e tyre! Popujt u vërsulën drejt tyre si egërsira drejt kafshatës së saj të lehtë e të njomë për dhëmbët!”[29]

Prandaj, detyra e secilit është të jetë i vëmendshëm në respektimin e fesë së Allahut, në veten e tij, në familjen e tij, në fëmijët e tij, në shoqërinë e tij, duke vlerësuar urdhëresat me zbatimin e tyre dhe duke iu nënshtruar Zotit në ndalesat e Tij, duke u larguar dhe distancuar prej tyre!

Në funksion të këtyre shënimeve, po lexoja një material me shumë vlerë nga Shejkh Ahmed Keftaro (1915-2004), në fund të cilit shkruan se:

“Edukimi i vërtetët fetar dhe besimi i sinqertë, janë ato që ndërtojnë në zemrën e poseduesit të tyre besën dhe kështillën, sinqeritetin dhe të vërtetën, dlirësinë dhe pastërtinë, në hak të atdheut dhe me njerëzit mbarë. Besimi i vërtetë, është ai që e largon të zotin nga pabesia dhe tradhtia, nga ligësitë dhe krimi, nga mashtrimi dhe dredhitë...”[30]

Zoti na faltë e na udhëzoftë dhe mos e bëftë asnjërin prej nesh “të vdekur në mesin e të gjallëve”, për të cilin, kur u pyet sahabiu i nderuar Hudhejfe ibnul-Jemani (r.a), tha: “Ai që nuk e ndalon të keqen, as me dorën e tij, as me gjuhën e tij dhe as me zemrën e tij!”[31]

(Referati i mbajtur në Konferencën e 12-të të imamëve, teologëve dhe thirrësve islamë të Myftinisë Shkodër)

21. *Dr. Muhammed Ratib En-Nabulsi, Tefsirun-Nabulsi, Sh.b. “El-Fursan”, botimi i parë, Aman, 2016, vëll. i 5-të, f. 173-174.*

22. *Shejkh Reshid El-Khatib El-Meusili, Tefsirul-Kur’anil-Adhim, Sh.b. “Ervika”, botimi i parë, Aman, 2014, vëll. i 4-t, f. 497.*

23. *Imam Ebu Hamid El-Gazali, Ihjau Ulumiddin, botimi i parë, Bejrut, 2000, vëllimi i 2-të, f. 384.*

24. *Kur’ani, El-A’rafë: 199.*

25. *Kur’ani, Ali Imran: 104.*

26. *Imam Fehrudin Razi, Et-Tefsirul-kebir, botimi i parë, Bejrut, 1990, vëllimi i 8- të, f. 145.*

27. *Kur’ani, Et-Teube: 71.*

28. *Transmetuar nga Imam Muslimi, nga Abdullah ibni Mes’udi (r.a).*

29. *Dr. Mahmud Akkam, Sebilul-ma’ruf, botimi i parë, Haleb, 1996, f. 14.*

30. *Zahir Ebu Davud, Min hedjil-Kur’an, Libraria Darul-mehabbe, Damask, pa vit botimi, f. 188.*

31. *Imam Ebu Hamid El-Gazali, vep. e cit., f. 383.*



PËR PROZATORIN E TALENTUAR SUAD ARILLA E MË GJERË

Xhahid Bushati, *shkrimtar*

Në Panairin e fundit, që u zhvillua në muajin nëntor të vitit të kaluar në Tiranë, teksa "shëtisja" plot vëmendje nga njëra stendë në tjetrën, po kërkoja edhe një stendë që të përfaqësonte Shkodrën, ashtu siç e bën Lezha, disa vite me radhë. Nuk e gjeta. E vetmja stendë që vinte nga Shkodra ishin Botimet Françeskane. Pasuria e tyre, e gjerë librore, ishte e pranishme e me dinjitet, edhe këtë vit në Panair, si në vitet e mëparshme. Traditë e bukur! U kujtova për Shkodrën se, shpesh thuhet për të "është djepi i kulturës". Nuk e di sa qëndron kjo shprehje aktualisht sot, kur stendë botimesh që të kishte emrin "Shkodra" nuk e pashë gjëkundi. Ka edhe një të vërtetë, krahas të vërtetave të tjera për këtë qytet të moçëm e të ditur se, ai jeton mes një raporti të traditës së pasur letrare me zhvillimin e letërsisë aktuale. Dhe po t'i krahasojmë traditën letrare për vlerat që mbart (ndonëse nuk ka njohje të plotë e studime prej shkencëtarësh) përsëri tradita e trashëgimia letrare e sfidojnë letërsinë aktuale.

Duke vazhduar udhëtimin tim në Panair, në një nga stendat e Sh. B. Albas gjeta emrin e një prozatori të ri që quhej Suad Arilla dhe prezantohej me romanin "Zanafilla". Ky ishte romani i dytë. Në vitin 2020, po nga kjo Shtëpi e vëmendshme Botuese, u botua romani "Libri i kujtimeve dhe i harresës". Ky libër është fitues i "Fondit të krijimtarisë letrare për të rinj", organizuar nga QKLL, me motivacionin: "Për një roman që përcjell te lexuesi luftën e brendshme të secilit personazh të stilizuar me mjeshtëri, gjithë pse-të e tyre, përpjekjet për të kuptuar veten, por dhe të tjerët, nëpërmjet një gjuhe të kujdesshme, leksiku të pasur dhe figuracioni të shprehur." Për një çast kisha menduar se do të kishte jehonë sadopak në qytetin e lindjes, sepse këto sihariqe nuk janë të zakonshme e të shpeshta. Isha gabuar. Në qiellin e shpresës nuk kishte edhe një rreze mirëseardhjeje. As shkolla e mesme ku ka kryer maturën Suadi, nuk u kujtua për të dy romanet të bënte një diskutim krijues. Më e vogla, Shkolla do të krenohej me një talent të tillë që pasuron denjësisht vlerat e saj. Këtë "fajësi" e riparoi Biblioteka "Marin Barleti". Në mjediset e saj, me dt. 11.01.2024, ora 16.00 u zhvillua një diskutim krijues për romanin "Zanafilla" të Suadit. Me gjithë të ftuarit me kahje drejt pasionit për letërsinë e librin, mendova se do të kishte më shumë mësues letërsie të shkollave të mesme, më shumë pedagogë të Universitetit "Luigj Gurakuqi" të Shkodrës. Pavarësisht kësaj mospjesëmarrjeje, aktiviteti ishte interesant, ku autori përmes dialogëve dhe pyetje shpalosi problematikat, ecurinë e krijimit deri në materializimin e tij, kulturën dhe sinqeritetin. Suadi si krijues i ri në rrugën e vështirë të romanit që ka zgjedhur të afirmohet, kushdo që do të lexojë romanet e tij, do të kuptojë e do të ndeshet me një krijues me tipare origjinale, që lexon me vëmendje romancierët bashkëkohorë, që mediton dhe reflekton këndshëm, që gjithsesi dashurohet me personazhin, "nuk e humbet atë", dhe përmes kapitujve e ndjek pas me sigurinë e krijuesit, për t'ua lënë lexuesve të gjykojë e pse jo të mbajnë dhe qëndrim.

Shkodra e ka pasur traditë zhvillimore gjininë e prozës. Veprat që ata kanë shkruar kanë talentin e tyre dhe kujtesën e kohës letrare. Janë bërë protagonistë në zhvillimin e letërsisë duke i dhënë asaj tipologji dhe arketipe të reja, duke e pasuruar atë me frymë jete. Përmendim: Ernest Koliqin, Migjenin, Skënder Drinin; për të ardhur më pas me Arben Prendin, Meritan Spahinë, Ridvan Dibrën,... e për të ardhur tek më i riu i talentuar Suad Arilla.

Po ç'mund të them më tej për Suadin? I kam edhe këto fjalë si mbyllje të shkrimit tim. E kam njohur Suadin. E kam pasur nxënës në Shkollë të mesme. I kam dhënë lëndën e letërsisë. E kujtoj, ishte i vëmendshëm, i dëgjueshëm, fliste pak dhe inteligjent. Nuk e di, a isha unë i fituar që kisha nxënës Suadin, apo ishte Suadi i fituar që më kishte mësues? Duke mos qenë kjo një lojë fjalësh, po them një gjë të sigurt: në rrugëtimin tonë, pavarësisht rrugëve të ndryshme letrare që kemi, të dy jemi të fituar. Sigurisht, Suadi ec më shpejt. Suadi, me talentin që ka, besoj që do të jetë një emër protagonizmi në letërsinë shqipe, veçanërisht në gjininë e romanit, gjini që e ka për zemër dhe e dashuron. Një dashuri prej krijuesi! Kjo hyn në optikën e vërtetësisë së punës që bën dhe që i fal subjekte të pafundme letrare.

Shkodër, më, 14.01.2024





O Zot, Mbret i mbretnive..!

O Zot
Mbret i mbretnive
Sundues i sundimtarëve
Me krejt të hirshmit emnat e Tu
Dhe lavdet që të thuren
prej njati ashku zemrash të zhrituna
Udhën që po erret para nesh, ndrite
Me një fije shprese, prej nurit Tand të pashuem
O Ti që je Një, e që s ka të dytë
Na mëso të përkulemi para hirësisë Tande
Për me u ba
Të papërkulshëm kundrejt asgjasë
O Krijues i gjithçkaje
Që sheh e dëgjon çdo tingull, çdo pipëtimë
Na avit ma pranë kroit ku jehon e Jotja melodi
E të përthithim me afsh
Dashninë që rrjedh prej andej
I Madhërishmi Zot
I pastër prej të kotave që t'i veshin të paditunit
Zhbëje mallkimin e hijeve, perdet e të cilit
Po na i mbulojnë zemrat
Të falemi
Të dorëzohemi
E të përgjërohemi
O Gjyqtar i fundit...

Imer Topanica
©I.T

H.T. Shejkh Ahmed Keftaro
(1915-2004)

"Islamit i mungon prezantimi, në tërësinë dhe thelbin e tij, në mënyrë pozitive! Allahu e ka garantuar Islamin si një program për lumturinë e njeriut nën hijen e lirisë së besimit: "Nuk ka dhunë në fé". Islami e bëri diturinë obligim për çdo njeri!

Islami ia obligon muslimanit kërkimin e dijes, madje të jetë dijetar, që mëson edhe të tjerët.

Historia na e vërteton këtë. Kudo ku ka hyrë Islami, në çdo vend, ai vend është kthyer nga gjendja e injorancës, prapambetjes, miteve e iluzioneve, drejt gradës së muslimanit dijetar!

Gjatë periudhës së sundimit islam, nga Andaluzia në Indi, nuk kishte vend të përparuar e vend të prapambetur! Civilizimi dhe qytetërimi islam i përfshiu të gjithë!"

(Nga arabishtja: Muhamed B. Sytari)

PARIMET MODERNE TË MËSIMDHËNIES NË EDUKIMIN E PROFETIT MUHAMED (A.S)

Besim Barbullushi
Imam, xhamia Rus

PARIMI I ORIENTUAR DREJT QËLLIMIT

Qëllimi; Është një veçori që një student është i vendosur ta fitojë nëpërmjet përvojave të planifikuara dhe të organizuara dhe është i përshtatshëm për t'u shprehur si ndryshim i sjelljes."[1] Gjëja e parë që duhet bërë në fillim të çdo procesi mësimor është të përcaktohen qëllimet që duhet të bëhen dhe arrihen. Programi që do të zbatohet duhet të jetë gjithashtu i një cilësie që arrin qëllimin e tij. Nxënësi duhet të jetë i informuar për qëllimet, duhet të jetë i vetëdijshëm se çfarë po mëson dhe pse.

Në programet arsimore, përgjithësisht përcaktohen tre lloje objektivash si të largët, të përgjithshëm dhe specifik. Synimi i largët është politika arsimore e shtetit; qëllimi i përgjithshëm, qëllimet e shkollave të përcaktuara në varësi të qëllimit të largët; qëllimi i veçantë janë objektivat e lëndës të përcaktuara në raport me objektivat e shkollave.[2]

Kurrikula e Profetit korrespondon me një periudhë afërsisht njëzet e tre vjet. Hz. Profeti e kreu procesin e mësimdhënies në përputhje me qëllimet e vendosura nga Allahu i Madhëruar.

Kur vlerësohet e gjithë periudha njëzet e tre vjeçare e mësimdhënies së Profetit, shihet se ka disa synime të largëta që Allahu i Madhëruar i ka vendosur në të mirën e njerëzve. Në literaturën islame këto synime quhen "qëllimi i krijimit". "A mendon njeriu se do të lihet pa mbikëqyrje?[3] Ajeti thotë se çdo njeri duhet të ketë synime në jetën e tij; Në ajetin: "Xhindët dhe njerëzit i kam krijuar vetëm për të më adhuruar Mua."[4], Zoti ynë e ka shprehur këtë qëllim në mënyrë të përgjithshme. Me shprehjen e adhurimit të Allahut nënkuptohet njohja e Allahut, rrespektimi i urdhrave të Tij dhe shmangia nga ndalesat e Tij.[5]

Përsëri, Allahu i Madhëruar u tregon njerëzve veprat e mira dhe të këqija që ata bëjnë në jetën e kësaj bote me ajetin "Pastaj ju bëmë mëkëmbës në tokë që të shohim se çfarë do të bëni."[6] Kështu, ai informoi se njerëzit duhet të synojnë të mirën në veprimet e tyre për të arritur lumturinë e të dy botëve.[7] Në fakt, në të gjitha ajetet e përmendura, vërehet një qëllim i përbashkët, që është arritja e profilit të një robi me të cilin Allahu është i kënaqur.[8]

Qëllimet e përgjithshme janë versioni më konkret i qëllimeve të largëta. Është më e lehtë dhe më e mundshme për t'u arritur sesa objektiva të largët. Këto synime janë në thelb pasqyrim i synimeve të largëta të shoqërisë në fushën sociale apo politike mbi arsimin. Qëllimet e përgjithshme mund të ndryshojnë sipas strukturës së shoqërisë dhe me kalimin e kohës. Për shembull, ndërsa qëllimi i përgjithshëm për vendet që janë të pazhvilluara në arsim është rritja e shkallës së shkrim-leximit, qëllimi i përgjithshëm për shoqëritë e informacionit mund të jetë fitimi i aftësive për njohjen e kompjuterit.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i edukimit islam është se ai vëzhgon strukturën dhe gatishmërinë e shoqërisë. Fakti që besimi në teuhid është përfshirë shpesh në ajetet mekkie të Kuranit tregon se shoqëria politeiste ka nevojë për disa reforma kryesisht në aspektin e besimit. Prandaj, i Dërguari i Allahut së pari i thirri arabët që jetonin në injorancë, në besimin e teuhidit. Në vitet e para të Islamit, qendra e kësaj thirrjeje ishte Daru'l-Erkam. Në bazë të zbritjes së ajeteve, Profeti u tha muslimanëve, të cilët mblidheshin këtu në kohë të caktuara të ditës, kryesisht disa koncepte islame si morali, besmeleja, dhikri, hamdi, durimi, tefsir, sirat-i mustakim, emrat dhe cilësitë e Allahut të Madhëruar dhe kështu synonte t'ua mësonte parimet e besimit islam.[9]

Shihet se objektivat janë zhvendosur pak më tej me fillimin e ndryshimit të strukturës teologjike të shoqërisë dhe rritjen e numrit të muslimanëve. Në fakt, me miratimin e parimeve të besimit, adhurimi, i cili është shenjë e adhurimit ndaj Allahut, është bërë obligim dhe janë përfshirë disa ndalesa.

Kur vlerësohet e gjithë periudha njëzet e tre vjeçare e mësimdhënies së Profetit, shihet se ka disa synime të largëta që Allahu i Madhëruar i ka vendosur në të mirën e njerëzve. Në literaturën islame këto synime quhen "qëllimi i krijimit". A mendon njeriu se do të lihet pa mbikëqyrje?

Megjithatë, farat e moralit të mirë janë mbjellë në zemrat e të gjithë njerëzve.

Detyra e "adhurimit" që Allahu i Madhëruar ua ka caktuar njerëzve si qëllim të largët, është mishëruar në mënyra të ndryshme me namazet, agjërimin, zekatin, emr-i bi'l-ma'ruf dhe disa ndalesa. Këto objektiva të përcaktuara mund të konsiderohen si objektiva të përgjithshëm për sa i përket të qenit më të ngushtë dhe më konkret se objektivi i largët.

Qëllimet e përgjithshme, nga njëra anë, "Si të adhurojmë?" është përgjigjia dhe bindja ndaj urdhrave dhe ndalesave që shoqërohet me vetëdijen e krijeses. Për shembull, nëse nuk do të ishte zhvilluar një proces i tillë gradual, robi nuk do të ishte i vetëdijshëm se pse dhe që po adhuron. Edhe pse kjo mund të jetë për shkak të gradualizmit. Edukimi në Islam përgjithësisht trajtohet nën katër tituj në literaturë: besimi, morali, adhurimi dhe trajtimi. Kur merret parasysh i tërë Kurani dhe procesi i shpalljes së tij, shihet se sa i saktë është ky klasifikim.[10]

Objektivat speciale janë objektiva që lidhen në një zonë të caktuar. Për shembull, qëllimet e lëndës së kulturës dhe etikës fetare në klasën e gjashtë apo ndonjë njësie janë specifike. Në këtë kontekst, qëllimet e Profetit lidhur me edukimin e namazit mund të konsiderohen si synime të veçanta. Në mënyrë të ngjashme, çdo temë si agjërimi, zekati, haxhi, parimet e besimit, jeta në ahiret, morali i mirë dhe dhikri ka qëllimet e veta specifike.

Për shembull, realizimi i faljes së namazit nuk ka të bëjë vetëm me shfaqjen e disa sjelljeve psikomotore. Qëllimi më i rëndësishëm i namazit është që t'i bëjë njerëzit mos të harrojnë krijuesin e tyre. Sepse, një person që tenton të humbasë në preokupimet e jetës së kësaj bote, e kujton të vërtetën përmes namazit. Një qëllim tjetër i namazit është që t'i pengojë njerëzit nga të këqijat.[11] Lidhja shpirtërore e krijuar nga një person që vjen në praninë e Allahut pesë herë në ditë me krijuesin e tij, me kohë përhapet në çdo aspekt të jetës së njeriut.

Kjo është kur një person largohet nga e keqja dhe bën një jetë në përputhje me pëlqimin hyjnor. Në të njëjtën mënyrë, mësimi i durimit dhe mirënjohjes ndaj njerëzve përmes agjërimit, përkujtimi i vështirësive të haxhit dhe jetës së përtejme, si dhe përforcimi i ndjenjave të bashkëpunimit dhe solidaritetit me bamirësinë janë vetëm disa nga qëllimet e këtyre lutjeve.

Në përmbledhje, procesi i edukimit të Profetit u zhvillua gjithmonë në kuadrin e qëllimeve hyjnore. Synimet e vendosura nga Allahu i Plotfuqishëm u përcollën nga Profeti ynë dhe u kujtuan adresuesve në intervale të ndryshueshme.

1. Selahattin Ertürk, Eğitimde Program Geliştirme, Yelkentepe Yayınları, Ankara 1979, fq. 25.
2. Selahattin Ertürk, Eğitimde Program Geliştirme, Yelkentepe Yayınları, Ankara 1979, fq. 14-15.
3. Kuran, Kijame 75/36.
4. Kuran, Zarijat 51/56.
5. Muhammed b. Ali b. Muhammed b. Abdillah esh-Shevkânî el-Jemenî, Fethu'l-Kadir, Dâru İbn-i Kesîr, Bejrut 1994, V, f. 110.
6. Kuran, Junus 10/14.
7. Fahreddin er-Râzî Ebû Abdillâh Muhammed b. Omer b. Huseyin et-Taberistânî, Mefâtîhu'l-Gayb, Dâru İhjâi't-Turâsi'l-Arabî, Bejrut 2000, XVII, fq. 222.
8. Kuran, Maide 5/16.
9. Muhammed b. Ali b. Muhammed b. Abdillah esh-Shevkânî el-Jemenî, Fethu'l-Kadir, Dâru İbn-i Kesîr, Bejrut 1994, V, fq. 152-172.
10. Muhammed Emin Yıldırım, Nebevî Eğitim Modeli Dârü'l-Erkâm (Vahyin İniş Sürecinde Şahsiyet Eğitimi), Siyer Yayınları, Stamboll 2012, fq. 121.
11. Kuran, Ankebut 29/45.

PROFILIZIMI KLERIKALIST APO KOMUNITARIST...

Nuk mundet dot shumica e heshtur e muslimanëve shqiptarë të identifikohet me faktet e kryera që ofron retorika ekskluziviste e qarqeve të ngushta klerikalo-komunitariste, me stërhollimet frikësuese të detajeve që i ofrohen para thelbit të mëshirshëm të Islamit..!

Ervin Hatibi

Profilizimi klerikalist apo komunitarist që ka marrë përfaqësimi islam ndër shqiptarët le pa mbuluar një shumicë të heshtur muslimanësh të thjeshtë të cilët nuk e gjejnë dhe nuk mund ta gjejnë dot veten as në retorikat rigoriste-ritualiste të imamëve tanë të rinj, as në agjendat e politizuara globaliste të veprimtarëve të rinj komunitarë e aq më pak në inaktivitetin dhe inferioritetin e organizatave të Islamit "zyrtar".

Kur të pakësohen gjykatësit dhe të shtohen avokatët në minberet e xhamive tona, kur veprimtarët tanë të pushojnë së sjelluri si diasporë dhe të braktisin diskursin minoritar të konspiracioneve alarmiste i cili prodhon vetëm geto që nuk na nxënë dot, vetëm kur organizmat "zyrtare" të Islamit të braktisin profilizimin e tyre si anekse firmash ndërtimi, dhe t'i kthehen mecenatit të kulturës dhe mbrojtjes se traditës e natyrës në vend, vetëm atëherë mbase do të mund të shohim sesi shumica e heshtur muslimane e shqiptarisë vetvetiu do mbrojë dinjitetin e vet. Se feja dhe prejardhja janë dinjitet.

Nuk mundet dot shumica e heshtur e muslimanëve shqiptarë të identifikohet me faktet e kryera që ofron retorika ekskluziviste e qarqeve të ngushta klerikalo-komunitariste, me stërhollimet frikësuese të detajeve që i ofrohen para thelbit të mëshirshëm të Islamit, nuk mund të pranojë shumica e heshtur e muslimaneve shqiptarë te rrezikojë duke u identifikuar në këto kohë të turbullta me një avangardë që shpesh duket se vepron për interes të të tretëve larg nesh duke shpërfillur historinë dhe çështjen kombëtare.

Sa kohë që lokomotiva e imamllarëve dhe veprimtarëve muslimanë nuk do tregojë haptas një itinerar të përgjegjshëm e te besueshëm, nuk ka për t'iu lidhur ndonjë vagon prapa. Dhe për të vazhduar me metafora mjetesh transporti, po kujtoj edhe hadithin fisnik i cili thotë se kur ata që gjenden në kuvertë të anijes, nuk u japin ujë atyre që janë në hambar, ata poshtë në hambar do shpojnë anijen për të pirë ujë deti, e anija e gjitha do të mbytet.



ÇINGHAI
PROVINCË E REPUBLIKËS POPULLORE TË KINËS

Çinghai është një provincë në veriperëndim të Republikës Popullore të Kinës, pa dalje në det. Provinca kufizohet me provincën Gansu në verilindje, me Rajonin Autonom Ujgur Shinxhang në veriperëndim, me provincën Siçuan në juglindje dhe Rajonin Autonom të Tibetit në jugperëndim.

Çinghai është provinca më e madhe e Kinës për nga sipërfaqja (duke përjashtuar rajonet autonome), me sipërfaqe 720,000 km2 , dhe ka popullsinë e tretë më të vogël, me 5,923,957 banorë (2020).

Kryeqyteti dhe qyteti më i madh në Çinghai është **Shining**.

GJEOGRAFIA

Provinca e ka marrë emrin e saj nga liqeni i madh Çinghai Hu (Liqeni Blu), i gjendur në pjesën verilindore të provincës, që njihet si Koko Nor. Liqeni Çinghai është liqeni më i madh me ujë të kripur në Kinë dhe i dyti më i madhi në botë.

Pjesa më e madhe e provincës përbëhet nga male dhe pllaja të larta, dhe ka një lartësi mesatare prej rreth 3,000 metra mbi nivelin e detit. Në veri të provincës gjenden vargmalet Altun dhe Çilian. Përmes pjesës jugore-qendrore të provincës shtrihen malet Bajan Har, të cilat ndihmojnë në përcaktimin e kufirit verior të rajonit të pllajës së Tibetit në Çinghai, dhe shërbejnë si pellg ujëmbledhës i burimeve kryesore të Huang He (Lumit të Verdhë) dhe lumit Jangtze. Në jug, kufiri Çinghai-Tibetan është paralel me malet Tanggula, ku ngrihen malet Jangtze. Midis këtyre maleve të larta ka lugina të gjera, zona kodrinore dhe rrafshnalta të gjera të sheshta.

Në pjesën veriperëndimore të provincës shtrihet pellgu i Kaidamit, një zonë e madhe e ulët, e gjendur midis vargmaleve Kunlun dhe Çilian. Pika e tij më e ulët është rreth 2,650 metra mbi nivelin e detit. Në zonat e pellgut rrëzë maleve dhe anëve të liqenit, ka shumë rrethina pjellore.

Pjesa jugperëndimore e provincës është një moçal i gjerë, i formuar nga një numër lumenjsh që rrjedhin nga malet Tanggula të mbuluara me borë.

KLIMA

Shtrirja dhe terreni kompleks i rajonit rezulton në ndryshime të mëdha në klimë, tokë dhe bimësi. Në përgjithësi, klima është kontinentale, duke u ndikuar nga largësia e rajonit nga deti dhe nga vargmalet në jug dhe lindje, që pengojnë erërat detare. Temperatura vjetore është përafërsisht -5 deri në 8 °C, me temperaturat e janarit që variojnë nga -18 në -7 °C, dhe temperaturat e korrikut që variojnë nga 15 në 21 °C. Reshjet mesatare vjetore në shumicën e vendeve janë më pak se 100 mm, shumica e të cilave bien gjatë verës. Dimri është i gjatë, i thatë, i ftohtë dhe me erë; vera me vendbanime. Gruri pranveror, elbi dhe patatet irlandeze, prodhohen me rendimente shumë të përmirësuara.

Në anën perëndimore është zona e rrafshnaltës, ku tufat e bagëtive, jakëve, kuajve dhe deleve - të cilat përfaqësojnë burimin kryesor të pasurisë së krahinës - kullosin në kullota të gjera. Prodhimi i leshit të deleve dhe jakut është i lartë dhe i cilësisë së mirë. Sipërfaqe të gjera toke baritore janë hapur për kultivim, duke sjellë atje një ekonomi të përzier bujqësi-blegtori. Aty prodhohet gruri dhe rapa vajore. Në pjesët juglindore dhe jugperëndimore të krahinës, blegtoria e përzier me bujqësinë e

është e shkurtër dhe e ngrohtë. Erërat e forta nga rrafshnalta Mongole e mbulojnë rajonin me rërë, duke përbërë një kërcënim serioz për bujqësinë. Nga ana tjetër, dielli i bollshëm në rajon është i dobishëm për rritjen e bimëve. Bari lulëzon në pllajën e madhe dhe rajoni zotëron disa nga kullotat më të mira të Kinës për dele, kuaj dhe jakë. Aty gjenden antilopa, kuaj të egër, ujqër, dhelpra, arinj, leopardë bore dhe zogj ekzotikë të rrallë, si lejleku me qafë të zezë.

EKONOMIA

Ekonomikisht, Çinghai ndahet në dy pjesë të mëdha. Në anën lindore është zona që laget nga Lumi i verdhë (Huang He), e përbërë nga sipërfaqe të mëdha tokash bujqësore të kryqëzuara nga kanalet vaditëse dhe të mbushura stacionuar, janë të shpërndara në zona të gjera. Vargmalet Kunlun dhe Çilian janë të pyllëzuara mirë dhe në to rriten bredhi, mështekna, pisha kineze dhe dëllinja kineze. Në zonat bujqësore ka pemishte me pjeshkë, kajsi, dardha, mollë dhe arra.

Shfrytëzimi i burimeve minerale ka qenë prej kohësh një komponent kryesor i ekonomisë së krahinës. Rezervat e naftës dhe gazit natyror ndodhen në pellgun e Kaidamit, i cili përmban shumicën e rezervave minerale të provincës. Çinghai është prodhuesi më i madh i litiumit në Kinë. Provinca ka gjithashtu depozita të pasura të kaliumit, stronciumit, bromit, kripërave, silikonit, magnezit, bakrit, plumbit dhe zinkut. Burimet e bollshme ujore në provincë janë shfrytëzuar duke ndërtuar

stacione të mëdha hidroelektrike në rrjedhën e sipërme të Lumit të Verdhë në Longiangshia (përfunduar në vitin 1992) dhe Lixhiashia (1996).

Që nga viti 1949, rritja industriale e provincës ka qenë e shpejtë. Në Shining dhe qytete të tjera janë ndërtuar fabrika kimike dhe makinerish, fabrika hekuri dhe çeliku, dhe firma të pajisjeve elektrike.

GJUHA

Gjuha zyrtare e provincës është gjuha Mandarin. Në rajone të ndryshme të saj flitet gjithashtu edhe Amdo Tibetiane, Salar, gjuha Yugur perëndimore, Oriat, Monguor, etj.

FEJA

Kinezët Hui përbëjnë pjesën më të madhe të atyre që ndjekin Islamin në provincë. Sipas një sondazhi të vitit 2010, 17.51% e popullsisë së Çinghait ndjekin Islamin.

Fetë mbizotëruese në Çinghai janë fetë popullore kineze dhe budizmi kinez midis kinezëve Han, kurse krishterimi është feja e 0,76% të popullsisë së provincës.

HISTORI

Toka e kultivueshme pranë Koko Nor (Liqenit Blu) ka qenë e njohur që në kohët parahistorike dhe mund të ketë qenë shtëpia fillestare e fiseve që u vendosën në Tibet. Rajoni Çinghai, i quajtur Amdo në gjuhën tibetiane, konsiderohej prej kohësh pjesë e Tibetit. Hanët iu referoheshin njerëzve të Koko Nor-it dhe më gjerë si Çiang, dhe u përpoqën t'i mbanin ata jashtë perandorisë Han (206 p.e.s–220 e.j) duke krijuar një post ushtarak pranë liqenit në vitin e 4-të të e.s. Posti ushtarak u braktis shpejt, por afër fundit të periudhës Han, gjatë mbretërimit të perandorit Shiandi (189–220), në lindje të Koko Nor u krijua prefektura Shiping. Në atë kohë, në atë zonë të thatë u zgjerua gradualisht bujqësia në fushën që filloi të ujitej.

Gjatë periudhës së fragmentimit politik pas rënies së pushtetit Han, një degë e fisit Shianbei themeloi një shtet me bazë në rajonin Çinghai, duke u shtrirë në lindje deri në Gansu-në e sotme. I quajtur Tujuhun, ky shtet zgjati më shumë se tre shekuj. Në shekullin e 7-të, dinastia Lhasa mori kontrollin mbi rajonin duke arritur kulmin e fuqisë së saj në shekullin e 8-të, atëherë kur territori i tyre u zgjerua shumë në verilindje.

Xhamia Dongguan, në kryeqytetin Shining

Gjatë periudhës Tang (618-907), kontakti midis Lhasës dhe Chang'an ishte miqësor. Karvanët e ngadaltë me jak dhe poni, transportuan murgj dhe pelegrinë budistë nëpër rajonin e shkretëtirës Çinghai dhe tregtarët u takuan pranë Koko Nor për të shkëmbyer kuajt e rritur në vend me çajin kinez.

Rajoni Çinghai u qeveris më vonë nga udhëheqësit Tangut, të cilët krijuan një shtet të quajtur Shi Shia, me bazë pranë Koko Nor, në vitin 1038. Xhengiz Khan e filloi fushatën e tij kundër këtij shteti në vitin 1205 dhe e përfshiu atë në Perandorinë e tij Mongole në zgjerim, në vitin 1227. Pas pushtimit mongol të Kinës së Veriut, Çinghai u bë pjesë e perandorisë Juan me qendër në Dadu (Pekin).

Gjatë periudhës Ming, rajoni Çinghai mbeti i lidhur ngushtë me Tibetin, pavarësisht pranisë atje të një komande ushtarake të caktuar nga qeveria Ming dhe pavarësisht rritjes së komunikimit me Kinën përmes misioneve tregtare. Në vitin 1642, në Tibet u krijua një dinasti mongole që zgjati deri në vitin 1717, kur një kryengritje lokale bëri që kinezët të ndërhynin drejtpërdrejt në punët e rajonit. Në vitin 1724 Çinghai u vendos nën administrim të veçantë nga dinastia Çing (1668–1911/12). Gjatë periudhës së Dinastisë Çing, emigrantët nga lindja u vendosën në Çinghai dhe ndikimi politik dhe kulturor kinez në rajon u rrit. Çinghai u bë provincë e Kinës në vitin 1928. Klani Ma qeverisi rajonin gjatë periudhës republikane, veçanërisht nën udhëheqësin autoritar Ma Bufang, i cili mbikëqyri disa zhvillime ekonomike atje. Pasi komunistët fituan kontrollin në vitin 1949, rritjes ekonomike në Çinghai iu kushtua një vëmendje e konsiderueshme, veçanërisht zhvillimit të rezervave minerale të provincës në pellgun e Kaidamit.

SI ERDHI ISLAMI NË ÇINGHAI

Çinghai është një nga provincat me numrin më të madh të muslimanëve. Ka pasur tri faza relativisht intensive të përhapjes së Islamit në këtë rajon.

Prezantimi për herë të parë i Islamit atje mund të thuhet se daton një mijë vjet më parë, qysh në kohërat e dinastive Tang dhe Song, dhe u soll nga tregtarët muslimanë arabë dhe persianë. Çinghai ishte një qendër e rëndësishme e Rrugës së Mëndafshit. Sidomos në kohën e Dinastisë Tang, dega Çinghai e Rrugës së Mëndafshit ka qenë shumë e rëndësishme. Këta muslimanë arabë dhe persianë që erdhën në Kinë për tregti, u vendosën në zonën Hehuang të Çinghait, dhe ky komunitet konsiderohen myslimanët dhe përhapësit më të hershëm të Islamit atje.

Faza e dytë ishte në shekullin e 13-të, në kohën kur Xhengiz Khan përfshiu Evropën dhe Azinë në perandorinë e tij. Një numër i madh aziatikësh perëndimorë shërbyen në ushtrinë e tij dhe morën pjesë në ekspeditat e kalorësisë mongole në jug dhe në veri. Këta aziatikë perëndimorë që ndoqën ushtrinë, qëndruan në korridorin Heshi në Gansu dhe në zonën Hehuang në Çinghai, u martuan me banorët vendas dhe përhapën Islamin në vend.

Faza e fundit ishte në fillim të shekullit të 14-të, kur popullsia Salar, që besonin në Islam, udhëtuan mijëra milje nga Samarkand në Azinë Qendrore, në Sunhua dhe vende të tjera në Çinghai, duke formuar një burim tjetër të rëndësishëm të përhapjes së Islamit në Çinghai.

Përgatiti:
Msc. Arta Ujkaj, *teologe*

https://www.britannica.com
https://en.wikipedia.org
http://www.muslimwww.com

“MUHAMEDI I VOGËL”

(Tregim i vërtetë nga historia e inkuizicionit në Andaluzi)

Me 2 janar 1492 ka rënë Granada, qyteti i fundit i kalifatit islam në Andaluzi.

Pastaj vazhduan torturat e tmerrshme të inkuizicionit për eliminimin e Islamit dhe të myslimanëve.

Shejkh Ali Tantavi

Atë kohë isha i vogël. Nuk kuptoja asgjë prej asaj që ndodhte fshehurazi, por shikoja babanë (Allahu e mëshiroftë), të shqetësuar dhe fytyrëzverdhur. Sa herë që kthehesha prej shkollës i lexoja ato që kisha mësuar prej “Librit të shenjtë” dhe çfarë kisha mësuar prej gjuhës spanjolle. Pastaj, ai më linte dhe largohej për në dhomën e tij në fund të shtëpisë, në të cilën nuk lejonte njeri të hynte. Qëndronte për orë të tëra brenda. Nuk e di se çfarë bënte aty, pastaj dilte prej saj me sy të skuqur, sikur të kishte qarë shumë. Qëndronte ditë të gjata duke më vështruar me hidhërim dhe keqardhje. Lëvizte buzët, sikur ai që do të flasë. Sapo u përgatisja për ta dëgjuar, më sillte shpinën dhe largohej nga unë pa më thënë asnjë fjalë.

Sa herë që nisesha për në shkollë, nëna më përcillte e mërzitur e me sy të përlotur. Më puthte fort me mall, duke mos u ngopur prej meje. Më thërriste përsëri, më puthte për së dyti dhe nuk më lëshonte, përveçse duke qarë.

Gjithë ditën ndjeja ngrohtësinë e lotëve të saj në faqet e mija. Mahnitesha prej të qarit të saj, duke mos e ditur shkakun përse vepronte kështu. Pastaj kur kthehesha nga shkolla më priste me keqardhje dhe e përmalluar, sikur unë t’i kisha munguar me dhjetëra vite. Shikoja nënën dhe babanë që largoheshin prej meje duke pëshpëritur me njëri-tjetrin, jo në gjuhën spanjolle. Nuk e njihja dhe as nuk e kuptoja atë gjuhë. Kur u afrohesha ndalonin bisedën, më largonin dhe fillonin të flisnin mes tyre spanjisht. Habitesha dhe njëkohësisht ndjeja dhimbje. Fillova të dyshoj me vetën time, sa arrita të mendoj se ndoshta nuk isha fëmija i tyre. Sikur unë të isha fëmijë i gjetur në rrugë, gjë që më shtonte dhimbjen. Strukesha në një qoshe të shtëpisë larg tyre dhe mbytesha me hidhërim duke qarë.

Dhimbjet zgjatnin për shumë kohë, saqë më bënë një natyrë ndryshe nga ajo e fëmijëve të tjerë të moshës time. Nuk përzihesha me ta në lojëra dhe dëfrime, madje i braktisja dhe largohesha prej tyre. Ulesha i vetëm, vendosja kokën mes krahëve dhe zhytesha në mendime. Përpiqesha të gjej zgjidhje... derisa vinte e më merrte për mënge të këmishës prifti, për të lexuar uratat në kishë.

Ishte nata e pashkëve. Granada ishte e zhytur në pije dhe në ndriçim. E kuqja ndriçonte me qirinj dhe drita. Kryqet nxirreshin nëpër dritare dhe kambanore.

Në mes të natës më thirri babai, ndërkohë që njerëzit e shtëpisë ishin të gjithë fjetë. Më mori në heshtje për në dhomën e tij, për në vendin e tij të shenjtë. Zemra filloi të më dridhej dhe u shqetësova, por e mbajta veten dhe u forcova.

Kur hyra në mes të dhomës, ai e mbylli mirë derën dhe filloi të kërkonte diçka për të na ndriçuar. Qëndrova në errësirë disa çaste, që për mua ishin më të gjata sesa vitet. Pastaj ndezi një kandil të vogël që e mbante në dhomë. U solla rreth vetes dhe pashë dhomën bosh, pa pasur gjë në të, prej asaj që unë kisha përfytyruar. Nuk kishte gjë tjetër vetëm një rrogoz, një libër të vendosur në raft dhe një shpatë të varur në mur.

Më uli në atë rrogoz dhe qëndroi i heshtur duke më parë me habi, sikur unë të isha me një njeri të huaj në një vend të frikshëm në mes të natës. Ndjeva sikur unë isha shkëputur nga bota, të cilën e lashë prapa kësaj dere dhe kisha kaluar në një botë tjetër. Nuk mund ta përshkruaj atë që ndjeva në ato momente.

Pastaj, babai më mori dorën me dashuri e butësi dhe me zë të trembur më tha: Biri im! Ti tani je dhjetë vjeç dhe je bërë burrë. Do të tregoj një sekret që e kam mbajtur të fshehtë larg teje. A mundesh ta mbash në kraharorin tënd, t’ia fshehësh nënës, familjes, shokëve dhe gjithë njerëzve të tjerë?

Një shenjë e vetme prej teje për zbulimin e këtij sekreti, do ta ekspozojë trupin e babait tënd për një dënim të xhelatëve të inkuizicionit.

Sapo dëgjova “inkuizicion” u drodha nga maja e kokës deri në fund të këmbëve. Me të vërtetë isha i vogël, por unë e dija se çfarë ishte inkuizicioni, sepse shikoja çdo ditë viktimat e tij, duke shkuar e duke u kthyer nga shkolla, (burra duke u kryqëzuar, ose duke u djegur, e gra të varura për flokësh derisa të vdisnin, ose të çara për barkut të tyre). Heshta dhe nuk iu përgjigja.

Babai më tha: Përse nuk përgjigjesh! A do ta mbash të fshehtë atë që do të të them?

I thashë: Po!

Tha: Ta mbash të fshehtë qoftë edhe me nënën tënde dhe me njerëzit më të afërt që ke?

I thashë: Po!

Atëherë më tha: Afrohu tek unë. Dëgjo me shumë vëmendje, sepse nuk mund ta ngre zërin lart. Kam frikë se mos muret kanë veshë dhe dëgjojnë, e më çojnë përpara inkuizicionit, ku mund të më djegin për së gjalli.

U afrova dhe i thashë: Po të dëgjoj me shumë vëmendje, babë.

Më bëri me shenjë nga libri, i cili ndodhej në raft dhe tha: A e njeh këtë libër, o biri im?

I thashë: Jo.

Ky është libri i Allahut.

I thashë: Libri i shenjtë, që e ka sjellë Jezusi, biri i Zotit?!

U shqetësua dhe më tha: Jo, jo, ky është Kur’ani, libri i Allahu, Një e i Vetëm, i Pashoq, që s’ka nevojë për askënd, por të tjerët kanë nevojë për Të. I Cili nuk ka lindur dhe as nuk është i lindur dhe askush nuk është i barabartë me Të. Atë ia zbriti krijesës më të mirë, zotërisë së Pejgamberëve të Tij, zotërisë tonë Muhammedit, të birit të Abdullahit, pejgamberit arab, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të.

Hapa sytë prej habisë dhe pothuajse nuk kuptova asgjë.

Vazhdoi: Ky është libri i Islamit. Islamit me të cilin Allahu dërgoi Muhammedin për mbarë njerëzimin! U shfaq atje, pas detit dhe stepave në shkretëtirën e largët dhe të thatë. Në Mekë, në popullin nomad, të përçarë, idhujtar e injorant. Ata i udhëzoi me këtë libër drejt teuhidit (njësisë), duke i dhënë me të unitet, forcë, dituri dhe qytetërim. Pastaj ata u nisën drejt Lindjes e Perëndimit, derisa arritën në këtë ishull, në Spanjë. Prunë drejtësi dhe u sollën mirë me njerëzit. U dhanë siguri jetës dhe pasurisë së tyre dhe qëndruan në këtë vend 800 vjet! Tetëqind vjet, duke e bërë vendin më të bukur dhe më të qytetëruar në të gjithë botën. Po, biri im, ne jemi myslimanë!

Nuk e mbajta gjuhën prej habisë, mahnisë dhe frikës dhe bërtita: - Çfarë jemi ne? Myslimanë?!

Ai tha: Po, biri im. Ky është sekreti që doja ta transmetoja te ti. Po, ne jemi të zotët e këtij vendi. Ne i ndërtuam këto pallate, të cilat ishin tonat dhe u bënë të armikut. Ne i ngritëm këto minare, në të cilat dëgjohej zëri i myezinit, ndërsa tani dëgjohet kambana. Ne i ndërtuam këto xhami, në të cilat myslimanët qëndronin në një saf (rresht) të vetëm përpara madhështisë së Allahut e përpara tyre imamët e ymetit lexonin në mihrabe fjalën e Tij. Ndërsa sot, ato janë kthyer në kisha, ku priftërinjtë dhe meshtarët lexojnë Ungjillin!

Po, o biri im... ne jemi myslimanë. Ne, në çdo cep të tokës spanjolle kemi gjurmët tona dhe poshtë çdo pëllëmbe toke kemi eshtrat e gjyshërve, ose dëshmorëve tanë. Po, ne i ndërtuam këto qytete, ne i ngritëm këto ura, ne i shtruam këto rrugë, ne i hapëm këto kanale dhe ne i mbollëm këto pemë!

Por, që dyzet vjet.., a po dëgjon? Që dyzet vjet u mashtrua mbreti i dëshpëruar, Ebu Abdullahi i vogël, mbreti i fundit i këtyre viseve, prej premtimeve të spanjollëve dhe aleatëve të tyre, duke ia dorëzuar çelësat e Granadës e duke lejuar dhunimin e ymetit dhe varret e gjyshërve të tij. Mori rrugën drejt Magribit për të vdekur atje, i vetëm pa njeri, i pastrehë, i braktisur. Na premtuan liri, drejtësi e pavarësi.

Sapo morën në dorë fatin tonë, thyen të gjitha premtimet dhe krijuan inkuizicionin. Na futën në krishterim me dhunë, na imponuan me forcë të braktisim gjuhën tonë. Na i morën fëmijët për t’i bërë më pas të krishterë.

Ky është sekreti i asaj që shikon duke u fshehur në kryerjen e adhurimit, zemërimin tonë për fenë që poshtërohet dhe fëmijët që me dhunë i bëjnë të ndryshojnë fe.

Dyzet vjet, o biri im dhe ne durojmë gjithë këto tortura, të cilat nuk mund t’i mbajnë dot as gurët e malit, duke pritur triumfin e Allahut. Nuk i humbim shpresat, sepse humbja e shpresës është e ndaluar në fenë tonë, feja e fuqisë, durimit dhe sakrificës.

Ky është sekreti, o biri im! Prandaj ruaje dhe dije mirë se jeta e babait tënd është e varur prej buzëve tuaja. Pasha Allahun, nuk e kam frikë vdekjen, as nuk e urrej takimin me Allahun, por dua të qëndroj gjallë derisa të ta mësoj ty gjuhën dhe fenë tënde, e të të shpëtoj prej errësirës së femohimit, me dritën e besimit. Tani ngrihu dhe shko në shtratin tënd, o biri im.

Pas kësaj, sa herë që shikoja ballkonet kuq, ose minaret e Granadës, me hipnin të dridhura të forta dhe ndjeja mall e zemërim, urrejtje e dashuri, që më mbushnin zemrën. Shumë herë tretesha në vetën time me orë të gjata dhe kur kujtohesha, sillesha rrotull kështjellës së kuqe duke i folur e duke e qortuar: O kështjella e kuqe! O ti e dashura e braktisur! A i ke harruar ndërtuesit e tu, të zotët e tu që të kanë ushqyer me shpirtrat dhe zemrat e tyre, që të kanë dhënë për të pirë nga gjaku dhe lotët? Dhe ti injorove besën që të dhanë dhe mohove dashurinë e tyre.

A i harrove mbretërit, të cilët shëtisnin nëpër madhështinë tënde, mbështeteshin pas shtyllave, duke të sjellë krenari e nder, bukuri e kënaqësi, ata, të nderuarit e krenarët? Të cilët kur flisnin, bota dëgjonte me vëmendje dhe kur urdhëronin koha përgjigjej se ishte e gatshme. A u miqësove me kambanat, pas ezaneve? A u kënaqe me meshtarët, pas imamëve?

Pastaj kisha frikë se mos më dëgjonin spiunët e inkuizicionit dhe nxitoja duke u larguar për të mësuar gjuhën arabe që po ma mësonte babai. Edhe tani e kam parasysh se si më thotë të shkruaj germat e alfabetit, pranë të cilave më shkruante germat e arabishtes e më thoshte: Këto janë shkronjat tona! Më mësonte shqiptimin dhe shkrimin e tyre, pastaj më jepte mësim fetar, ku më mësonte abdesin dhe namazin për t’u falur së bashku, fshehurazi, në atë dhomë të fshehtë e të frikshme.

Frika ekzistonte gjithmonë nga shkaku se mos rrëshqisja dhe e shfaqja sekretin. Kështu, ai fuste nënën për të më sprovuar dhe ajo më pyeste: Çfarë po të mëson babai?

Prej mjeteve të torturave që inkuizicioni përdorte ishin prerja e gjymtyrëve me gjëra të mprehta.

Përgjigjesha: Asgjë nuk po më mëson!

Ajo thoshte: Ti ke diçka që fsheh prej asaj që ai të mëson, prandaj mos ma fsheh mua?

I thoja: Ai nuk po më mëson asgjë!

Derisa përsosa gjuhën arabe, kuptova Kur’anin dhe mësova shtyllat e fesë Islame, ai më njohu me një vëlla të tijin në fe. Mblidheshim të tre për ibadet dhe Kur’an.

Pas kësaj u rrit më tepër ashpërsia e inkuizicionit dhe u shtuan torturat ndaj pjesës tjetër të mbetur të arabëve. Nuk kalonte ditë që ne të mos shikonim njëzet ose tridhjetë të kryqëzuar, apo të djegur në zjarr për së gjalli. Nuk kalonte ditë pa dëgjuar për qindra e qindra të tjerë të torturuar, në mënyrat më të dhimbshme e më çnjerëzore. U shkuleshin thonjtë, e ata i shikonin me sytë e tyre. U jepej për të pirë ujë, derisa të mbyteshin. Këmbët e duart u digjeshin dhe gishtërinjtë u priteshin. Ua piqnin në zjarr, pastaj ua fusnin në gojë.

Goditeshin me kamxhikë derisa mishi u binte përtokë.

Kjo gjë vazhdoi për kohë të tëra. Një ditë, babai më tha: Ndjej, o biri im, se më është afruar exheli dhe kam dëshirë të bie dëshmor (shehid) nga duart e tyre. Ndoshta Allahu më jep xhenetin dhe të arrij fitoren e madhe. Në këtë botë nuk më ka mbetur dëshirë tjetër, pos asaj që të nxora nga errësira e femohimit dhe të ngarkova amanetin e madh, pesha e të cilit gati sa nuk më mbyti. Në qoftë se mua më godet diçka, bindu xhaxhait tënd dhe mos e kundërshto në asgjë.

Ditët kaluan. Ishte natë e errët prej netëve të sekreteve. Papritur vjen xhaxhai. Më thirri dhe më urdhëroi të shkoj me të. Më tha: Allahu na e ka lehtësuar një udhëtim për në Magrib, vend myslimanësh! I thashë: Po nëna dhe babai im?

Më shikoi me ashpërsi dhe me forcë më tërhoqi prej dore duke më thënë: A nuk të ka urdhëruar babai yt të më bindesh?

Vazhdova me të i vogël, pa dëshirë, derisa u larguam nga qyteti, kur na përfshiu errësira tha: Duro, o bir! Allahu ka shkruar për prindërit e tu lumturinë, nga dora e inkuizicionit.

Kështu djali shpëtoi për në tokën e Magribit dhe u bë dijetar i madh. Ai është Shejkh Muhammed ibn Abdurefi Andaluzi, prej të cilit, (desh Allahu) njerëzit përfituan shumë prej botimeve dhe dijes së tij të gjerë.

Biografia e personazhit të tregimit:

Muhammed ibn Abdurefi Andaluzi: Muhammed ibn Abdurefi ibn Muhammed Sherif Husejnij Mersij Andaluzi. Jetoi në Tunis. Zerekliu përmend se në faqet e fundit të librit “El-Envar en-Nebevije”, është shkruar me shkrimin e tij:

Mbaruan së mbledhuri dhe së shkruari kapitujt e këtij libri, ditën e xhuma në Tunis, në vitin 1044, prej dorës së robit të Allahut, Muhammed Abdurefi Sherif Xhaferij Andaluzi Mersij. I vdekur, tarikat dhe medhheb malikij dhe i varrosur në njërën prej dy xhamive të shenjta, inshallah. Vdiq në vitin 1052 h.

Përktheu nga arabishtja dhe përshtati në shqip: **Lavdrim Hamja**

IMAM DIDMAR FAJA: "TË MENDOJMË MIRË PËR ZOTIN TONË DHE TA BËJMË TË DASHUR PËR TË TJERËT!"

Pavarësisht vizitës së shkurtër disaditore në Shkodër, Imam Didmar Faja, Kryetar i Komunitetit Mysliman Shqiptar në Arizona dhe Imam e Drejtues i United Islamic Center of Arizona , pranoi me kënaqësi ftesën e Myftiut të Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, për të mbajtur hytben e xhumasë së datës 19 janar 2024, në xhaminë e "Dy Vajzave".

Pas dersit të përjavshëm, të mbajtur nga hatibi i kësaj xhamie, thirrësi islam Lavdrim Hamja, të pranishmit patën rast të dëgjojnë këshillat e dobishme të Myftiut të shqiptarëve në Arizona, djalit të lagjes Tophanë, shkodranit të suksesshëm në ShBA, Imam Didmar Faja.

Në hytben e tij, Myftiu i nderuar hodhi dritë mbi një temë me shumë dobi për besimtarët, sidomos në këto ditë të begata të muajit të shenjtë Rexheb dhe domosdoshmërisë së përmirësimit të marrëdhënies së njeriut besimtar me Zotin e tij.

Ai foli për konceptet e njohjes së Allahut dhe mendimit të mirë që duhet me ketë muslimani për Zotin, dhe se si duhet ta paraqesim Krijuesin, Zotin e botëve para të tjerëve, si Falës, Mëshirues, por dhe Ndëshkues, etj.

Ndër të tjera theksoi se në jetën e besimtarit, ka shumë rëndësi tobja (pendimi), për të vërtetuar se forca e besimit qëndron mbi cytjet e shejtanit që e tërheq njeriun drejt gjynaheve dhe devijimit.

Ai tha se kjo periudhë e vitit, është kohë e begatë dhe mundësi e mrekullueshme që besimtarët të bëjnë llogaritë e tyre në marrëdhënie me Zotin dhe me njëri-tjetrin, për të vazhduar rrugëtimin e kësaj jete, përherë në ngritje.

SIHARIQ!

Myftinia Shkodër, ka kënaqësinë e madhe t'ju bëjë me dije, se pas disa përpjekjesh për të siguruar një projekt të denjë për xhaminë e re të lagjes Tophanë, falë bashkëpunimit me "Qatar Charity", tashmë çdo detaj i projektit të ri, përfshi miratimin nga Kryesia e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, lejen e ndërtimit nga Bashkia Shkodër dhe sigurimin e mjeteve të duhura për zhvillimin normal të punimeve, janë plotësuar.

Gjatë javës që shkoi, nisën punimet e para për lirimin e objektit të xhamisë dhe përgatitjen e terrenit për nisjen normale të punimeve intensive.

Historikisht, lagjja e Tophanës ka pasur xhaminë e saj, e para e të cilave, u ndërtua në vitin e largët 1617.

Nga ajo kohë e deri më sot, xhamia ka qenë pikë referimi për besimtarët dhe qytetarët shkodranë.

Në vitin 1996, nisi puna për ndërtimin e xhamisë së re të lagjes, në hapësirat e mbetura të vakëfit të gjerë të kësaj lagjeje.

Përtej mirëmbajtjes dhe ndërhyrjeve të shpeshta të bëra në atë objekt, Myftinia Shkodër gjykoi se xhamia kishte nevojë të zëvendësohej me një të re, në shërbim të qëllimeve të aktivitetit të saj.

Pjesë e projektit të ri, do të jetë edhe pjesa e mbetur e portikut të vjetër të xhamisë Tophanë, që sipas marrëveshjes së hershme me donatorin, do të integrohet në ndërtimin e ri, si një gjurmë e respektuar e trashëgimisë sonë të vjetër islame.

Allahut i lutemi për mbarësi dhe suksese.

Myftinia Shkodër shpreh mirënjohje dhe respekt për krejt besimtarët dhe qytetarët e interesuar për xhaminë e re, projektin e saj dhe dëshirën për të kontribuuar vullnetarisht për çdo nevojë të mundshme në këtë rrugëtim të begatë!

Me mbarësi dhe bekime!

DITËT DHE NETËT E SHËNUARA ISLAME (2024 | 1445-1446 H)

12.01.2024	Fillimi i Tre Muajve të Mirë
06.02.2024	Nata e Mirë e dytë - Israja dhe Miraxhi
24.02.2024	Nata e Mirë e tretë - Gjysma e muajit Shaban
11.03.2024	Dita e parë e agjërimit të Ramazanit
05.04.2024	Nata e Kadrit
10.04.2024	Dita e parë e Fitër Bajramit
15.06.2024	Dita e Arafatit
16.06.2024	Dita e parë e Kurban Bajramit
07.07.2024	Dita e parë e Vitit të Ri Hixhri 1446
16.07.2024	Dita e Ashurasë
14.09.2024	Ditëlindja e Pejgamberit (a.s) (Mevludi Sherif)

BULETINI I PËRVITSHËM I MYFTINISË SHKODËR, VAZHDON RRUGËTIMIN E TIJ...

Me mbarësinë e Allahut, që nga viti 2010 e deri më sot, vjetari i Myftinisë Shkodër, "Buletin" vazhdon të dalë rregullusht. Vëllimi i 13-të tashmë në duart tuaja!





U ZHVILLUA TRIBUNA FETARE: “TRE MUAJ BEKIM DHE AFRIM!”

Ditën e diel, më 14 janar 2024, pas namazit të akshamit, në xhaminë e Parrucës, Myftinia Shkodër organizoi me rastin e fillimit të Muajve të Mirë një tribunë fetare me temë: “Tre Muaj bekim e afrim!”.

Në këtë aktivitet të parë të Myftinisë për vitin 2024 merrnin pjesë imamë, teologë dhe besimtarë të moshave të ndryshme.

Pas fjalës së hapjes nga teologu Arben Halluni, u prezantua një program i shkurtër me lexim Kur’ani, recitime dhe ilahi nga nxënësit e mejtepit fetar të xhamisë Bardhaj.

Në vijim të aktivitetit imamët H. Naim Drijaj dhe H. Ensar Ismajlaj mbajtën nga një ligjëratë, të cilët folën rreth rëndësisë, vlerës dhe dobive që sjellin te besimtarët muajt e Mirë: Rexhep, Shaban dhe Ramazan, çfarë duhet të punojmë prej veprave të mira dhe adhurimeve gjatë këtyre muajve, që të afrohemi më tepër tek Allahu dhe të fitojmë kënaqësinë e Tij.

TRE MUAJT E MIRË, LIGJËRATA NË XHAMINË E LAGJES KIRAS

Ditën e shtunë, më 20 janar 2024, pas namazit të drekës, në xhaminë Kiras, Myftinia Shkodër organizoi me rastin e fillimit të Muajve të Mirë tribunën e radhës me temë: “Tre Muaj bekim e afrim!”.

Në këtë aktivitet merrnin pjesë imamë, teologë dhe besimtarë të moshave të ndryshme.

Pas fjalës së hapjes nga imami i xhamisë Kiras, H. Ruzhdi Plangaj, mbajtën ligjëratat e tyre imamët e nderuar, H. Durim Kasemi, me temë: “Takvaja, si sekret mbarësie në jetë” si dhe H. Ardit Hoxha, me temë: “Agjërimi, si dëshmi e përuljes me dashni ndaj Allahut (xh.sh)”.

Të dy imamët e nderuar, përmes temave përcollën vlerën e takvasë (devotshmërisë) si pjesë e rëndësishme e besimit, adhurimit dhe moralit islam si dhe këshilla të dobishme në lidhje me përgatitjen shpirtërore dhe fizike përmes agjërimit vullnetar dhe veprave bamirëse në mënyrë për të mbërritur në përshpirtmërinë më të madhe që e karakterizon zotërinë e të gjithë muajve të vitit, muajin e begatë të Ramazanit.

Këto tribuna fetare do të vazhdojnë gjatë këtyre tre muajve të mirë edhe në xhami të tjera të qytetit dhe të fshatit.

MYFTIU PRITI NË NJË TAKIM TË PËRZEMËRT, KRYETARIN E KOMUNITETIT MYSLIMAN SHQIPTAR TË ARIZONËS IMAM DIDMAR FAJA

Ditën e hënë, më 22 janar 2024, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një takim të përzemërt e vëllazëror, Kryetarin e Këshillit të Imamëve të Arizonës, njëkohësisht Kryetar i Komunitetit Mysliman Shqiptar të Arizonës dhe imam e drejtues i United Islamic Center of Arizona, Imam Didmar Faja.

Gjatë takimit të përzemërt, u këmbyen mendime për punën dhe aktivitetin e gjerë, si dhe forcimin e bashkëpunimit në drejtim të përhapjes së vlerave të dëshmuara islame tradicionale, si pjesë e pandarë e identitetit tonë kombëtar.

Më herët, me ftesë të Myftiut të Shkodrës, ditën e xhuma, më 19 janar 2024, Imam Didmar Faja mbajti hytben e xhumasë në xhaminë e “Dy Vajzave”.

Imam Didmar Faja shërben si imam në Arizona të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, që nga viti 2000 dhe ka një aktivitet të gjerë dhe me kontribute të çmuara në fushën e Thirrjes Islame, në SHBA dhe jashtë saj.

Myftinia Shkodër falënderon Imamin e nderuar, i cili sa herë që viziton vendlindjen e tij, Shkodrën, është pjesë e pandarë e aktiviteteve të Myftinisë Shkodër, me hytbe dhe ligjërata në raste dhe ceremoni të ndryshme.

PESHORJA E GJYKATËS NDËRKOMBËTARE!

UKRAINË - 16 MARS 2022

Federata Ruse duhet të pezullojë menjëherë operacionet ushtarake që filloi më 24 shkurt 2022 në territorin e Ukrainës.

Gjykata është thellësisht e shqetësuar për përdorimin forcës nga Rusia, e cila po shkakton një problem “Shumë të rrezikshëm sipas ligjit ndërkombëtar.”

Joan Donoghue

Kryetare e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë

GAZA - 26 JANAR 2024

Izraeli duhet të marrë masa brenda kufijve të autoritetit të tij për të ndaluar dhe ndëshkim e nxitjeve hapurazi ndaj kryerjes së gjenocidit kundër palestinezëve.

Izraeli duhet të paraqesë brenda një muaji një raport në Gjykatë në lidhje me masat e përkohshme të vendosura.

Joan Donoghue

Kryetare e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë

(TRTARABIJ)

ZHVILLOHET KONFERENCA E 12-TË VJETORE E IMAMËVE: “NJERIU, BARTËS I AMANETIT!”

Paraditën e së shtunës, më 27 janar 2024, në xhaminë Kiras u zhvillua konferenca e 12-të vjetore e imamëve, teologëve dhe thirrësve islamë të Shkodrës, me temë: “Njeriu, bartës i amanetit!”

Referatet e përgatitura nga imamët ishin të larmishme dhe interesante, me tefsire të ajeteve kur’anore, komentime të haditheve profetike dhe tema të tjera fetaro-shkencore, rreth përgjegjësisë dhe amanetit njerëzor, me të cilin Allahu i Madhëruar e ka ngarkuar njeriun në këtë botë.

Në fjalën e tij, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, ndër të tjera tha: “Vendi i predikuesit nuk duhet t’i lihet dokujtdo, por atij që zotëron të gjitha cilësitë e meritueshme të një predikuesi. Dekadat e fundit po bëhen përherë e më shumë më të egra për muslimanin shqiptar, thuaj këtu me njeriun mbarë, atë evropian dhe në mbarë botën, duke i afruar atij modele dhe shembuj që nuk janë e as nuk mund të jenë bashkudhëtar me botën e tij, me shpirtin e besimit dhe vlerat e Islamit. Ditë pas dite, shoqëria jonë islame po përballet me një propagandë sa të fshehur, aq të dukshme në thelbin e të cilës është frika ndaj Islamit dhe tendenca për ta paraqitur atë si një fenomen keqbërës e të kobshëm, që për shekuj e shekuj i paska mbërthyer për fyti shqiptarët dhe i cili duhet të çlirohet patjetër nga ky islam e të kthehet në fenë e të parëve, e të kthehet, e të kthehet... çfarë nuk po dëgjojmë e dëgjojmë prej lajthitjeve kolektive aty këtu në trojet tona shqiptare. Por kjo nuk është e vërtetë, është qesharake, është paradoks..!”

Në konferencë u spikat roli i njeriut besimtar dhe musliman në bartjen e amanetit të të qenurit mëkëmbës i Zotit në tokë dhe se njeriu ka përgjegjësinë kryesore në mbarëvajtjen e jetës në tokë.

Në këtë konferencë referuan:

1. **Imam Muhamed Sytari** – Tefsir: “Kush i përmbahet udhëzimit Tim, ai nuk ka për të humbur (në dunja) e as nuk ka për të dështuar (në jetën tjetër)” – (TaHa: 123)

2. **Adem Pizga** – Komentim i hadithit: “Më i dashuri i njerëzve tek Allahu është më i dobishmi i tyre...”

3. **Anis Agovi** – Komentim i hadithit: “Çdonjërit prej jush i tubohet krijimi i tij në barkun e nënës...”

4. **Arben Halluni** – Personaliteti njerëzor

5. **Ardit Hoxha** – Tefsir: “Unë do të bëj në tokë mëkëmbës!” – (El-Bekare: 3)

6. **Ardit Ulqinaku** – Tefsir: “Ne ia prezantuam amanetin qiejve..!” – (El-Ahzab: 72)

7. **Durim Kasemi** – Tefsir: “Të pyesin ty për shpirtin!” – (El-Isra: 85)

8. **Ensar Ismajlaj** – Tefsir: “Ju kemi bërë popuj e fise, që të njiheni!” – (El-Huxhurat: 13)

9. **Lavdrim Hamja** – Humanizmi dhe toleranca e muslimanëve përgjatë historisë

10. **Naim Drijaj** – Tefsir: “Njeriu është i ngutshëm!” – (El-Isra: 11)

11. **Samel Haxhija** – Rinia në Kur’an dhe në Traditën e Hz. Muhammedit (a.s).

Kjo konferencë ishte e 12-të, të cilin Myftinia Shkodër e organizon me imamët, teologët dhe thirrësit islamë të Shkodrës. Të gjitha referatet e mbajtura në konferencë botohen në një libër të veçantë në mënyrë të zgjeruar.

MEJTEPI IM... XHAMIA XHAFERAJ

Pak histori:

- Xhamia e lagjes Xhaferaj e fshatit Oblikë, ndodhet në Njësinë Administrative Ana e Malit, Bashkia Shkodër.

- Aktualisht, lagja Xhaferaj përbëhet me rreth 30 familje myslimane.

- Fiset më të njohura janë: Plaku, Cani, Ceni, Cufi, Hysi, etj.

- Në vitin 2001, në tokën që dhuruan vakëf Sadik Cani (Bajram dhe Tahir Xhilaj) dhe Cen Cafi, u ndërtua xhamia e re në lagjen Micaj më kontributin banorëve të fshatit, të Myftinisë Shkodër etj. Ndërsa në vitin 2020 xhamia është riparuar plotësisht nga shoqata kuvajtiane “Duart e Bamirësisë”.

- Imamët e xhamisë Xhaferaj dhe njëkohësisht edhe mësues të mejtepeve që kanë shërbyer nga viti 2002 dhe në vazhdim janë: Ali Hysejn Hysi dhe imami aktual Indrit Cani.

- Numri i nxënësve që kanë frekuentuar rregullisht rreth 8 mejtepe dhe kurse të ndryshme fetare të mësim-besimit, të zhvilluar në periudha të ndryshme nga viti 2002-2024 është mbi 90 nxënës.

Takimi me nxënësit:

Sektori të arsimit pranë Myftinisë Shkodër, në kuadër të takimeve me nxënësit e xhamive që frekuentojnë kurset/mejtepet e mësim-besimit, drejtuesi dhe inspektori i arsimit, teologu Arben Halluni zhvilloi ditën e diel, më 28 janar 2024 një takim me nxënësit e mejtepit/kursit fetar të xhamisë Xhaferaj, me praninë e mësueses Suada Gërdeci dhe nën kujdesin e imamit Indrit Cani.

Drejtuesi i arsimit, pasi u njoh me ecurinë e procesit mësimor, zbatimin e programit, pjesëmarrjen e nxënësve në kursin veror intensiv etj, u mbajti një bisedë, duke u përqendruar në rëndësinë dhe vlerën që ka organizimi i mejtepeve fetare pranë xhamive dhe për misionin që ato mbartin si përçimin te brezi i ri mësimet e vërteta fetare, edukatën islame që duhet të ketë çdo besimtar dhe frymën e mirë paqësore që duhet të karakterizojë çdo njeri në marrëdhëniet me të gjithë njerëzit, me krijesat e Zotit në tokë, etj.

Në fund, u zhvillua edhe një bashkëbisedim dhe pyetje-përgjigje rreth mësimeve që marrin nxënësit në këtë mejtep.

KOMUNITETI MYSLIMAN I SHQIPËRISË
MYFTINIA SHKODËR

KONTRIBUO EDHE TI!

PROJEKT PËR XHAMINË E PARRUCËS

Fteso për kontribut!

Myftinia Shkodër ju fton të bëheni pjesë e projektit për rehabilitimin e xhamisë së Parrucës, që përkon me izolimin, lyerjen, ndryshimin e sistemit të ndriçimit, atij të zërimit dhe shtrimin e tapetit të ri.

Për vëllezërit dhe motrat në Shkodër, kontributet tuaja mund t'i dorëzoni pranë xhamisë së Parrucës, tek dy imamët, ose pranë zyrës së administratorit të Myftinisë Shkodër.

Për të interesuarit nga jashtë vendit, kontributin tuaj mund ta dërgoni në llogarinë bankare të Myftinisë Shkodër:

United Bank of Albania – Branch Shkoder
MYFTINIA SHKODER – FONDE BAMIRESIE
Nr. IBAN LEK:
AL11-2035-1102-2010-1521-1100-0546
Nr. IBAN USD:
AL50-2035-1102- 2010-1401-1100-0543
Nr. IBAN EUR:
AL61-2031-0025-1702-0015-0000-0210

Pejgamberi (a.s) ka thënë:

"Kush ndërton një xhami për hir të Allahut, Allahu i ndërton atij një shtëpi në xhenet!"

(Transmetuar nga Ibn Maxheh)

WHATSAPP
+355 67 455 3880 | MAIL@MYFTINIA-SHKODER.ORG

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

MYFTINIASHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org

Çmimi: 50 lek